



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2019:298795  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05424305

**E.nr.528/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Xh.K. nga Shtimja, të cilin e përfaqëson av Qëndrim Reçica nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 07.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.528/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.528/22, të datës 04.05.2022, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.1593/19, të datës 08.10.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 06.09.2022 dhe 07.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, t'i transferoj shumat e mjeteve prej 1,717 euro dhe 510.93 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.528/22, më datë 07.03.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**